



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 94 prot.

Kamëz, më 20.11.2025

V E N D I M  
Nr. 78.Datë 20/11 2025  
M B I

**“MIRATIMIN E PLANIT TË AKTIVITETEVE TË KËSHILLIT BASHKIAK KAMËZ  
PËR VITIN 2026”.**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 20.11.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.73 Datë 14.11.2025 në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronjat “a” dhe “b”, nenit 16, nenit 18, neneve 51 deri 58 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar); Ligjin Nr. 146/2014, "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik", Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.33 datë 21.03.2024 për: “Miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Kamëz”, me propozim të Kryesisë së Këshillit Bashkiak, duke pasur parasysh se hartimi i planit të aktiviteteve synon përcaktimin e një kornize orientuese mbi punën dhe aktivitetin e Këshillit të Bashkisë Kamëz, duke pasur parasysh fuqizimin, ruajtjen e autonomisë së Këshillit, si edhe siguron ushtrimin e funksionit legjislativ si organ përfaqësues, vendimarrës, mbikëqyrës e monitorues, dhe se ky plan aktivitetesh është orientues dhe mundet të ndryshojë për çdo emergjencë, apo situatë të paparashikueshme në momentin e hartimit të tij, **Këshilli Bashkiak Kamëz”;**

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e Planit të Aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Kamëz, për periudhën 1 Janar - 31 Dhjetor 2026, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli Bashkiak Kamëz dhe Sekretariati i Këshillit Bashkiak.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

KRYETAR KËSHILLI  
HYSEN KOLDASHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

PLANI I AKTIVITETEVE KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Fokusi: Transparenca, Llogaridhënia dhe Zhvillimi Komunitar.

<b>Dokumenti:</b>	Plani i Aktiviteteve Këshilli Bashkiak
<b>Periudha Kohore:</b>	1 Janar 2026 – 31 Dhjetor 2026
<b>Baza Ligjore:</b>	Ligji nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, dhe Rregullorja e Funksionimit të KB Kamëz.
<b>Objektivi Strategjik:</b>	Garantimi i një procesi vendimmarrës gjithëpërfshirës, transparent dhe efikas, duke u fokusuar në monitorimin e zbatimit të buxhetit, përmirësimin e shërbimeve publike dhe forcimin e dialogut me komunitetin.
<b>Propozuar nga:</b>	Kryesia e Këshillit Bashkiak

Nr.	Muaji	Fokusi Kryesor Mujor	Përshkrimi i Aktivitetit	Rezultati i Pritshëm
I.	Janar	Nisja e Planifikimit & Komisionet	Mbledhje Këshilli (Plenare): Diskutim dhe miratim i prioriteteve vjetore 2026.	Miratimi i Prioriteteve Vjetore 2026.
			Mbledhje Komisionesh (Financë, Gjinore, Urbanistikë): Shqyrtimi i objektivave kryesore të vitit.	Raportet e Komisioneve mbi fokusin e punës së tyre.
			Hartimi i Planit Dyvjeçar të Trajnimit (Këshilltarë & Sekretariat).	Miratimi i Planit Dyvjeçar të Trajnimit.
			Informacion nga administrata sipas kërkesës së këshilltarëve.	Marrja e informacionit zyrtar për çështjet e ngritura.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

II.	Shkurt	Shërbimet Publike & Konsultimet e Para	Mbledhje Këshilli (Plenare).	Vendime të rëndësishme mbi rregullat e shitjes/dhënies me qera.
			Mbledhje Komisionesh (Financë, Shërbime Publike, Juridike): Fokus te përmirësimi i shërbimeve.	Dokument i përgatitur për përmirësimin e shërbimeve publike.
			Konsultime me komunitetin (2 NjA & 2 Grupe Interesi) për shitje, blerje dhe dhënie me qera pronash.	Raport i detajuar i Konsultimeve me sugjerimet e komunitetit.
			Hartimi i Planit Vjetor të Komunikimit dhe Konsultimit me Publikun.	Miratimi i Planit të Komunikimit 2026.
III.	Mars	Trajnimi & Llogaridhënia Vjetore	Mbledhje Këshilli (Plenare).	Vendime lidhur me financat dhe urbanistikën.
			Mbledhje Komisionesh (Financë, Gjinore, Urbanistikë).	
			Trajnim i Këshilltarëve (Me Fond të Këshillit): Qeverisja Vendore, Monitorimi i Vendimeve, Analiza Financiare e Buxhetit.	Rritja e kapacitetit të Këshilltarëve në analizën financiare.
			Analizë e Performancës T1 2026 dhe Hartim i Raportit Vjetor.	Finalizimi i Raportit Vjetor 2026.
			Takimi Vjetor i Këshillit me Qytetarët: Prezantimi i Raportit Vjetor të Veprimtarisë.	Demonstrim i llogaridhënies para komunitetit.
IV.	Prill	Draft PBA & Rinore	Mbledhje Këshilli (Plenare).	Miratimi i ndryshimeve të nevojshme buxhetore.
			Mbledhje Komisionesh (Financë, Shërbime Publike).	
			Konsultime me Komunitetin (3 NjA Kamëz, 2 NjA Paskuqan, 2 Grupe Interesi, 1 Pyetësor Online) për Draft PBA.	Mbledhja e opinionëve për Draft PBA.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

			Aktivitet me Rininë (në kuadër të komisioneve rinore).	Përfshirja aktive e rinisë në proceset vendimmarrëse.
			Pjesëmarrje në takime ndërbashkiake.	Shkëmbim përvojash me këshilla homologe.
V.	Maj	PBA & Kapacitetet Digjitale	Mbledhje Këshilli (Plenare).	Vendime për zhvillimet e reja infrastrukturore.
			Mbledhje Komisionesh (Financë, Juridike).	
			Konsultime me Komunitetin (2 NjA, 2 Grupe Interesi, 1 Pyetësor Online) për Draft PBA, ndryshim buxheti, norma dhe standarde të shërbimeve publike.	Konsultimi i detajuar për normat e shërbimit publik.
			Trajnim për Përdorimin e Mjeteve Digjitale në punën e Këshillit dhe Mbrojtja e të Dhënave Personale (GDPR).	Rritja e sigurisë dhe efikasitetit në komunikimin digjital.
VI.	Qershor	Miratimi i PBA Fazës I	Mbledhje Këshilli (Plenare).	Miratimi i Raporteve të T2.
			Mbledhje e Këshillit për Miratimin e PBA Faza I.	Miratimi i PBA Faza I.
			Mbledhje Komisionesh (Financë, Juridik, Shërbime Publike).	Shqyrtim i planit të menaxhimit të mbeturinave.
			Shqyrtim i zbatimit të vendimeve kryesore të marra në T1.	Raport i progresit mbi vendimet e T1.
VII.	Korrik	Llogaridhënia Sektoriale & Komunikimi	Mbledhje Këshilli (Plenare).	Miratimi i ndihmave ekonomike (6%).
			Mbledhje Komisionesh (Financë, Gjinore, Shërbime Publike).	
			Emision në Median Vendore dhe Online (Diskutim me qytetarët mbi shërbimet bashkiake).	Rritja e ndërgjegjësimit publik për shërbimet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

			Takime të Kryesisë së Këshillit me organizata partnere.	Forcimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile.
VIII.	Gusht	Pushimet Verore (Fokus në Stabilitet)	Mbledhje Këshilli (Plenare).	
			Mbledhje Komisionesh (Financë, Gjinore).	
			Konsultime dhe aktivitete me qytetarët dhe grupe interesi për projektet e vitit.	Mbledhja e reagimeve për projektet në zhvillim.
			Diskutime për Njësitë e Performancës dhe Zyra të Zhvillimit Ekonomik Lokal (ZhEL).	Përcaktimi i hapave për ngritjen e Zyrës së ZhEL.
IX.	Shtator	Roli i KB & Trajnimet me Partnerë	Mbledhje Këshilli (Plenare).	Miratimi i ndryshimeve të reja në rregullore.
			Mbledhje Komisionesh (Financë, Urbanistikë, Juridike).	
			Trajnime të Këshilltarëve me Bashkëpunim me Partnerë (Fokus te Kodet Etike).	Aplikimi i praktikave të reja të punës.
			Draftimi i Planit Vjetor të Vendimmarjes dhe Buxhetit të Këshillit Bashkiak.	Përgatitja e dokumenteve planifikuese për vitin pasardhës.
			Monitorimi i Punës së Kryesive të Fshatrave dhe Ndërlidhësve Komunitarë (Përfshirë një vizitë në terren).	Vlerësim i nevojave dhe problemeve në NjA.
X.	Tetor	Arsimi Parashkollor & Trajnimi i Sekretariatit	Mbledhje Këshilli (Plenare).	Vendime për çështjet juridike dhe financiare.
			Mbledhje Komisionesh (Financë, SHARSKT, Juridike).	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

			Konsultime me Komunitetin (2 NjA + 5 Grupe Interesi) për Rregulloren e Arsimit Parashkollor.	Miratimi i rregullores së re të arsimit parashkollor.
			Trajnim i Sekretariatit/Sekretarëve (Fokus te Arkivimi Digjital dhe Menaxhimi i Dokumenteve).	Rritja e efikasitetit administrativ.
			Pritje e delegacionit nga Këshilla Homologe.	Shkëmbim përvojash dhe nënshkrimi i marrëveshjeve.
XI.	Nëntor	PBA (Finale) & Tituj Nderi	Mbledhje Këshilli (Plenare).	Vendime të rëndësishme për pronat bashkiake.
			Mbledhje Komisionesh (Financë, Shërbime, Prona).	
			Konsultime me Komunitetin për PBA (5 NjA - Kamëz, Bathore, Laknas, Paskuqan, Babrru - 2 Grupe Interesi Biznes & OJQ).	Mbledhja e opinioneve përfundimtare për PBA.
			Ceremoni Dhënie Titull Nderi (5).	Nderimi i figurave të shquara të qytetit.
XII.	Dhjetor	Miratimi i Buxhetit & Përmbledhja Vjetore	Mbledhje Këshilli (Plenare).	
			Mbledhje e Këshillit për Buxhetin & PBA (e Dytë, nëse nevojitet).	Miratimi i Buxhetit Vjetor 2027 dhe PBA Përfundimtare.
			Mbledhje Komisionesh (Financë, Urbanistikë, Gjinore).	
			Përmbledhje Përfundimtare e Vitit 2026 dhe Planifikim për 2027.	Finalizimi i raporteve të punës dhe planifikimi i ri.
			Ceremoni Dhënie Titull Nderi (2).	